

Filloi viti ri shkollor në institucionet arsimore të Kishës sonë



Më 27 shtator, filloi mësimi në të gjitha shkollat e ngritura nga Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë, që funksionojnë brenda Fondacionit “Fryma e Dashurisë”. Këtë vit, mësimi nuk filloi online, por përsëri me rregulla e kufizime të diktuar nga situata pandemike që vazhdon ende. Kështu, është e detyrueshme që personeli arsimor të jetë plotësisht i vaksinuar, numri i nxënësve në klasa është i kufizuar etj. Edukimi i brezave më të rinj, jo vetëm shpirtërisht nëpërmjet mësimave të katekizmit, por edhe nëpërmjet institucioneve arsimore të ngritura nga Kisha, ka qenë gjithmonë një nga objektivat kryesorë të punës. E gjitha e bazuar mbi interesimin e veçantë, mundësitë e krijuara dhe fondet e siguruar nga Kryepiskopi Anastas.

Të parët i kishin hapur dyert kopshtet e arsimit parashkollor, të cilat frekuentohen në gjithë vendin nga rreth 700 fëmijë.

Shkollat 9-vjeçare dhe të mesme këtë vit shkollor frekuentohen nga rreth 2000 nxënës, duke dëshmuar përsëri kërkesa në rritje për t’u regjistruar në to. Kjo jo vetëm për rezultatet e larta të arritura, por edhe për mjediset bashkëkohore të

krijua dhe disiplinën, që krijon qetësi e siguri.

Në të gjithë vendin nisi mësimi në këto institucione arsimore parauniversitare të ngritura nga Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë: Shkolla 9-vjeçare dhe shkolla e mesme shqiptaro - amerikan "Protagonistët", në Tiranë; shkolla 9-vjeçare shqiptaro - greke, "Frymë Dashurie", pranë kishës së Shën Gjergjit në Durrës; shkolla 9-vjeçare dhe shkolla e mesme shqiptaro - greke në Gjirokastrë; Liceu "Platon" në Korçë; shkolla e mesme profesionale dhe ajo e mesme e përgjithshme "Frymë Dashurie" në





[Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë](#)